

Thirrje për Aplikim në Seminaret e ofruara nga ERA

Të nderuar përfitues të Akademisë së Drejtësisë së Kosovës,

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se Akademia e Drejtësisë Kosovës në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA) po e ndanë me ju njoftimin e ERA's për mundësitë ndjekjes së Serisë së **Trajnimeve për vitin 2024**, për gjyqtarët dhe prokurorët nga Kosova.

Qeveria e Kosovës së fundi i është bashkuar skemës së financimit të BE-së të quajtur Programi CERV (Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat). Në kuadër të Programit CERV, ERA zbaton dy programe trajnimi në shkallë të gjerë mbi "Të Drejtën e BE-së kundër diskriminimit" dhe "Të Drejtës së BE-së për Barazinë Gjinore". Këto projekte – përfaqësojnë dymbëdhjetë seminare në vit në mbarë Evropën – tani janë të hapura për gjyqtarët dhe prokurorët nga Kosova.

SHËNIM: numri i pjesëmarrësve është i kufizuar në 2 pjesëmarrës për secilin aktivitet (ju lutemi të caktoni ato me prioritet - Pjesëmarrësit e interesuar duhet të kenë njohuri të gjuhës Angleze)

Falë financimit themelor të BE-së, ERA do të jetë në gjendje të kontribuojë ndjeshëm në kostot e udhëtimit dhe akomodimit të pjesëmarrësve të interesuar për ndjekjen e trajnimeve si vijon:

SEMINARET MBI TË DREJTËN E BE-SË KUNDËR DISKRIMINIMIT:

Vendi, datat dhe gjuha:

- Vilni, 5-6 shtator 2024, gj. Angleze/Lituaneze – afati fundit: 14 korrik 2024

SEMINARET MBI TË DREJTËN E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE:

- Kopenhagë, 15-16 prill 2024, gj. Angleze – afati fundit: 29 shkurt 2024
- Paris, 7-8 nëntor 2024, gj. Angleze/Frënge – afati i fundit: 15 shtator 2024

Shënim: Të dy seritë e seminareve financohen plotësisht nga Komisioni Evropian dhe janë të hapura për pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve evropianë.

SEMINARET MBI TË DREJTËN E BE-SË KUNDËR DISKRIMINIMIT:

Kjo seri seminaresh trajton Direktivën e BE-së kundër diskriminimit 2000/78 dhe 2000/43 (që mbulon diskriminimin në bazë të racës, moshës, aftësisë së kufizuar, fesë dhe orientimit seksual).

Vendi, datat dhe gjuha:

- Zagreb, 6-7 maj 2024, gj. Angleze/Kroate – afati fundit: 14 mars 2024
- Madrid, 24-25 shtator 2024, gj. Angleze/Spanjolle – afati i fundit: 15 korrik 2024
- Valetta, 14-15 nëntor 2024, gj. Angleze/Italiane – afati i fundit: 20 shtator 2024

Kushtet financiare:

Për të gjitha këto seminare, ERA mund të rimbursojë pjesëmarrësit deri në 450 EUR të kostove të udhëtimit dhe ne do të mbulojmë drejtpërdrejt 2 netë akomodimi në hotel.

SEMINARET MBI TË DREJTËN E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE:

Kjo seri seminaresh i kushtohet të Drejtës së BE-së për barazinë midis grave dhe burrave.

Vendi, datat dhe gjuha:

- Sofje, 6-7 qershor 2024, gj. Angleze/Bullgare – afati i fundit: 15 prill 2024
- Trier, 9-11 dhjetor 2024, gj. Angleze/Portugeze – afati i fundit: 10 tetor 2024 (ju lutem vini re se programi përfshin një vizitë në GJED në Luksemburg më 10 dhjetor)

Kushtet financiare:

Për të gjitha këto seminare, ERA mund të rimbursojë pjesëmarrësit deri në 450 EUR të kostove të udhëtimit dhe ne do të mbulojmë drejtpërdrejt 2 netë akomodimi në hotel.

Për më shumë info: www.era.int/anti-discrimination

Për më shumë info: www.era.int/gender.